**20130701511**

# L I GJ
# PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR AUTOMJETE

Neni 1

Në Ligjin për automjete (“Gazeta Zyrtare e Republikes së Maqedonise” numer 140/2008, 53/11 dhe 123/12), në nenin 11 paragrafi (1) alineja 7 shlyhet.

Neni 2

Në Ligjin për ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit për automjete (“Gazeta Zyrtare e Republikes së Maqedonise” numer 123/12), në nenin 52 paragrafi (2) fjalet: “në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji" zevendesohen me fjalet: "deri më 30 qershor 2014".

Neni 3

Propozimet për legalizimin e traktoreve dhe rimorkiove të traktoreve që nuk jane parashtruar në pajtim me afatin nga neni 53 paragrafi (5) të Ligjit për ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit për automjete (“Gazeta Zyrtare e Republikes së Maqedonise” numer 123/12), mund të parashtrohen në periudhen prej 10 prillit 2013 deri më 30 shtator 2013.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në diten e tete nga dita e botimit në “Gazeten Zyrtare të Republikes së Maqedonise”.